Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Analizat e biznesit (zgjidhjet)

P11

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 01.07.2023

Problemi 1

Saranda Krasniqi gjendet në dilemë. Ajo është ftuar të bëhet anëtare e bordit si drejtoreshë joekzekutive për kompaninë Grupi Moda e Re, por është e pasigurtë sa i përket kontributit të saj strategjik të grupit. Saranda ka reputacionin për të ndihmuar bizneset në vështirësi financiare dhe është përkrahëse e madhe dhe inkurajuese e bizneseve që të bëjnë analiza të thukta, në mënyrë që të identifikojnë çështjet për përmirësim dhe te përpiqen të përmirësojnë efikasitetin dhe përmirësimet e performancës.

Grupi Moda e Re ishte krijuar nga një ekip burrë e grua në vitet 1970 në një pjesë ekonomikisht jo të zhvilluar të Rumanisë. Ata prodhuan një gamë gjithëpërfshirëse të veshjeve të grave të ndërtuara rreth temës së stilit dhe elegancës tradicionale - Rumania është e njohur ndërkombëtarisht për vlerat e saj tradicionale, konservatore dhe udhëheqjen patriarkale.

Grupi kishte aftësitë e nevojshme për të dizejnuar, prodhuar dhe shitur me pakicë gamën e produkteve të tij. Marka Moda e Re u krijua shpejt dhe kompania krijoi një rrjet besnik furnizuesish, punëtorësh në fabrikën e kompanisë dhe shitës me pakicë ekskluzivë të përhapur në mbarë botën. Produktet e Grupi Moda e Re ishin në gjendje të përcaktonin çmime premium në botën e modës. Rita dhe Betim Mjeku siguruan që përkushtimi i tyre ndaj vlerave tradicionale të krijonte një atmosferë të fortë familjare në rrjetin e partnerëve të saj dhe hezitonin ta ndryshonin këtë gjë.

Fatkeqësisht, ndryshimet në tregun e veshjeve të grave paraqisnin një kërcënim të madh për Modën e Re. Së pari, gratë ishin bërë një pjesë shumë më aktive e fuqisë punëtore dhe kërkonin veshje më të zgjuara, më funksionale për t'u veshur në punë. Stili i vëshjeve të Modës së Re nuk ishtë më në trend. Së dyti, kontrolli i rreptë i ushtruar nga Betimi dhe Rita Mjeku dhe angazhimi i tyre për kontrollin e dizajneve, prodhimit dhe shitjes me pakicë, i bëri ata më pak konkurues në treg.

Së treti, pati një hezitim nga pronarët dhe ekipi i tyre drejtues për të pranuar se një rënie e konsiderueshme e shitjeve dhe fitimeve ishin si rezultat i një ndryshimi thelbësor në kërkesën për veshje për femra. Në një vizitë të fundit në një shitës me pakicë, Saranda mori komentet e mëposhtme të rastësishme nga disa vizitorë të dyqanit:

"Unë kam blerë rroba nga marka Moda e Re për më shumë se 25 vjet dhe i dua ato. Nuk mendoj se do të mendoja ndonjëherë të shkoja diku tjetër për fustanet dhe këpucët e mia.'

"Unë kam dalë vetëm për disa rroba banjo. Mamaja ime blen këtu gjatë gjithë kohës, por unë preferoj dyqanet më trendi.'

"Shiqoj shpesh herë rrobat në Moda e Re. Por përgjithësisht unë konstatoj se mund të merrni rroba nga Hana të cilat janë pothuajse po aq të mira dhe sa gjysma e çmimit. Hana mund të mos kenë gjithmonë të njëjtën cilësi, por unë jam i lumtur t'i blej artikujt e tyre dhe t'i zëvendësoj ato rregullisht.

Në diskutimin me departamentin e marketingut të Moda e Re, Saranda zbuloi se këto komente ishin mjaft tipike të asaj që thoshin vizitorët e dyqanit. Departamenti i marketingut shpjegoi se këto komente ishin dëgjuar për disa vite, por Betimi dhe Rita vazhduan të besonin se ky ishte një fenomen afatshkurtër që do të zhdukej po aq shpejt sa çdo 'trend' tjetër.

Saranda zbuloi se tregu kishte ndryshuar ndjeshëm. Në njërën anë, qeveria ruritane kishte hequr sistemet e kuotave që ishin vendosur për të kufizuar sasinë e produkteve që mund të bliheshin jashtë shtetit. Kjo do të thoshte që mundësitë ishin që të blihen produkte cilësore jashtë shtetit me çmime që ishin dukshëm më të ulëta se kostot e prodhimit të prodhuesve tradicionalë ruritanë. Në të njëjtën kohë, disa rivalë vunë re rritjen e shitjeve të revistave të grave dhe programeve televizive të fokusuara për gratë. Më pas ata filluan të përdorin këto rrugë për të promovuar produktet e tyre përmes vendosjes së produkteve dhe reklamave tradicionale. Moda e Re, megjithatë, vazhdoi të mbështetej në biznesin e përsëritur dhe fjalën e gojës ("word of mouth").

Rezultati ishte se çmimi i aksioneve të kompanisë ra në mënyrë dramatike. Betimi dhe Rita ruajtën një pjesë të konsiderueshme të pronësisë së pakicës (interesi minoritar) por kompania kishte pasur Drejtor të ri Ekzekutiv çdo vit që nga viti 2000.

Kërkohet:

(a) Shkruani një raport të shkurtër për Saranda Krasniqin duke identifikuar dhe shpjeguar pikat e forta dhe të dobëta strategjike në Grupit Moda e Re. **(14 pikë)**

(b) Vlerësoni kontributin që mund të japë krahasimi për përmirësimin e pozicionit të Grupit Moda e Re dhe çdo kufizim për dobinë e tij. **(11 pikë)**

(Total: 25 pikë)

Zgjidhja e Problemit 1

(a) Pozicioni strategjik

Për: Saranda Krasniqin

Nga:

Pikat e forta dhe të dobëta strategjike në Grupi Moda e Re

Duke kryer një analizë të pikave të forta dhe të dobëta strategjike, bëhet e qartë se çfarë më parë ishin pikat e forta shpeshherë bëhen pikat e dobëta ndërsa mjedisi konkurrues ndryshon me kalimin e kohës. Analiza e pikave të forta dhe të dobëta është e përqendruar në anën e brendshme të biznesit dhe zakonisht lidhet me një vlerësim të jashtëm të mundësive dhe rreziqeve të jashtme që përballon kompania. Grupi Moda e Re është qartë në një pikë krize dhe ka nevojë për një kthesë strategjike për të mbijetuar. Modeli i biznesit që ua ka shërbyer atyre kaq mirë nuk është më i përshtatshëm për botën e modës në të cilën ata tani konkurrojnë. Rita dhe Betimi kanë ndërtuar një model të lartësisë vertikale, që ua ka dhënë kontroll të konsiderueshëm mbi rritjen dhe zhvillimin e kompanisë. Në terma të zinxhirit të vlerës, marrëdhënia që ata kanë ndërtuar me furnizuesit ka qenë e përkrahur reciprokisht dhe ka lehtësuar dukshëm zgjerimin global të grupit. Kontrolli ishte edhe më i fortë mbi projektimin, prodhimin dhe shitjen e produkteve të kompanisë. Moda e Re kishte zhvilluar me sukses një treg të veçantë për produktet e saj, duke u bazuar në vlera tradicionale. Kjo i ka lejuar atyre të zgjerohen me sukses dhe të zhvillojnë një reputacion botëror për shkëlqimin e dizajnit dhe cilësinë.

Fatkeqësisht, mjedisi konkurrues i tyre është ndryshuar konsiderueshëm, duke u bërë gjithnjë e më i konkurrueshëm dhe armiqësor. Ekonomia e prodhimit të veshjeve është ndryshuar. Shijet e grave në veshje gjithashtu kanë ndryshuar dhe tani nuk ka më treg për veshjet që Moda e Re shet. Kontrolli i ngushtë ushtruar nga themeluesit ka penguar njohjen e këtyre ndryshimeve. Moda e Re ka vazhduar të ndjekë dizajne të vjetëruara dhe procese të shtrenjta të prodhimit që i kishin shërbyer mirë në të kaluarën. Ka pasur një njohje e cila tregon natyrën strategjike të problemeve, siç tregohet edhe nga radhët e CEO-ve që nga viti 2000 që u dhanë detyrë të parandalojnë rënien e shitjeve dhe të zvogëlojnë kostot. Fatkeqësisht, ndryshimet në mjedisin e tyre kanë sjellë disa pasiguri nëse Moda e Re është një markë, një prodhues, një shitës ose një kompani e integruar e modës.

Është gjithashtu e paqartë nëse ekziston ende ndonjë avantazh konkurrues strategjik. Kompania duket se është "kapur në mes". Nga njëra anë, ata nuk kanë kontrollin e kostos, ekonomitë e shkallës ose qasje në importet e lira të huaja që do të ishin të nevojshme për të konkurruar në pjesën e poshtme të tregut. Por nga ana tjetër, veshjet e tyre shihen si të vjetëruara, me markë të dobët dhe të papërshtatshme për tregun që do të ishte e nevojshme për të konkurruar në pjesën më të lartë të tregut. Kjo bëhet edhe më keq nga teknikat e dobëta të marketingut dhe mungesa e planifikimit strategjik ose analizës së jashtme. Sepse kompania duket se është kapur pa kujdes nga ndryshimet në treg (ose ndoshta kontrolli dhe qëndrimi i pronareve "prit dhe shiko" kanë detyruar kompaninë të injorojë këto ndryshime), kompania është lënë pas rivalëve.

Në përgjithësi, Moda e Re, nga një pozicion strategjikisht i mirë, tani ka nevojë për një kthesë strategjike të shpejtë. Produktet dhe tregjet e saj kanë ndryshuar; marrëdhëniet që ka me palët e interesit kyçe nuk janë më pika e tyre e fortë dhe zinxhiri i vlerës dhe sistemi i saj nuk ofrojnë më vlerë të dallueshme për klientët e saj.

(b) Vlerësimi i rezultateve në Moda e Re nuk do të jetë gjë e lehtë. Moda e Re ka zhvilluar një mënyrë të dallueshme për të arritur tregjet e saj, kështu që krahasimet direkte do të jenë të vështira për t'u bërë. Sigurisht, ajo mund të kryejë vlerësim historik në krahasim me se si proceset dhe veprimtaritë e veta kanë përmirësuar, ose ndryshe, gjatë një periudhe relevante kohore. Fatkeqësisht, kjo pritet të konfirmojë thjesht dobësimin e performancës dhe të shtojë pak në atë që Saranda tashmë ka zbuluar.

Ajo mund të krahasojë veprimtaritë e saj kyçe me "më të mirët në klasë"; pavarësisht se nga cila industri vjen performuesi i shkëlqyeshëm. Ajo mund të kishte dhe duhet të kryente krahasime konkurruese në anën e shitjes së biznesit ku informacioni duhet të jetë më lehtë i qasshëm. Mund të ketë një mundësi për të krahasuar veten me firma që kanë kaluar nëpër një krizë të ngjashme dhe kanë arritur një kthesë të suksesshme.

Procesi duhet të fillojë me një vlerësim të faktorëve kritikë të suksesit që janë të rëndësishëm për mjedisin aktual të biznesit, si inovacioni, marka, çmimi dhe cilësia. Pas kësaj, duhet të lidhen ndikuesit kyç të performancës (kjo mund të jetë, për shembull, një synim për përqindjen e blerjeve nga furnizuesit e huaj). Synimet për secilin ndikues të performancës mund të vendosen duke përdorur benchmarking. Duke përdorur shembullin e dhënë, nëse qëllimi për kompaninë është të zbresë në treg, atëherë përqindja e blerjeve mund të synohet nga dyqanet e ngjashme që tashmë ndjekin një strategji të tillë, siç është Hana.

Benchmarkingu pastaj mund të zgjerohet edhe përtej rivalëve, kështu që ndikuesit e performancës si shitjet për punonjësinë mund të krahasohen me industritë e tjera, në mënyrë që Moda e Re jo vetëm të përputhet dhe të kapërcejë rivalët ekzistues, por të synojë të i tejkaloi ata dhe të caktojë standarde më të larta për industrinë në të ardhmen dhe të sigurojë që problemet e përjetuara gjatë disa viteve të fundit të mos përsëriten.

Në lidhje me avantazhet dhe disavantazhet e benchmarkingut, gatishmëria e menaxherëve përgjegjës për një fushë kyçe të performancës për të krahasuar veten me masa të jashtme të rëndësisë së përshtatshme dhe dispozitave të shtrenjta përcakton nëse benchmarking-u mund të jetë një përfitim i vërtetë për organizatën.

Problemi 2

ABC Travel është biznes udhëtimi me një rrjet prej 50 degësh në një numër qytetesh të mëdha në të gjithë Austrinë.

ABC Travel ofron tre lloje të produkteve për pushime, të njohura brenda kompanisë si "Family, Outdoors dhe Golden Travel".

'Family' ofron pushime kryesisht për familjet me fëmijë, ndërsa 'Outdoors' kujdeset për njerëzit e moshës kryesisht midis 20 dhe 30 vjeç, të cilët dëshirojnë pushime relativisht të lira të bazuara në aventura. 'Golden Travel' ofron pushime të shtrenjta dhe të porositura që u shiten kryesisht çifteve, fëmijët e të cilëve janë rritur dhe janë larguar nga shtëpia. Kompania mbështet produktet e saj kryesore duke ofruar sigurime udhëtimi dhe këmbim valutor.

Stafi

ABC Travel punëson 550 staf me kohë të plotë. Qarkullimi i stafit është relativisht i ulët. Personelit i paguhen shpërblimet e performancës së lartë për sa i përket bonuseve në çdo degë nëse ajo përmbush ose tejkalon objektivat e shitjeve tremujore. Stafi gjithashtu merr bonus shtesë nëse është në gjendje t'u shesë klientëve sigurimin e udhëtimit së bashku me një produkt pushimi.

Stafi kalon nëpër një program dyditor të trajnimit dhe njoftimit në fillimin e punësimit të tyre me kompaninë. Theksi i këtij programi është në shërbimin ndaj klientit dhe jo në detajet në lidhje me produktet pasi pritet që stafi i ri të njihet me detaje të tilla të produktit pasi ata fitojnë përvojë brenda kompanisë.

Pas analizës së përfitimit relativ të secilit lloj produkti, ABC travel ka identifikuar se paketat e saj 'Golden Travel' - ndërkohë që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të kompanisë - kanë kthyer fitime relativisht më të ulëta në krahasim me gamën e produkteve të tjera të saj për shkak të më mos arritjes së të ardhurave të planifikuara.

Propozimi i drejtorit të operacioneve

Drejtori i Operacioneve (OD) ka rekomanduar që ABC Travel të krijojë një markë të re për të mbuluar produktet e saj premium, Golden, të quajtur 'YourWay'. 35 dyqanet më të mëdha të ABC Travel do të ridizajnohen pjesërisht për të krijuar një seksion të ri të dedikuar për klientët YourWay.

Në çdo dyqan, do të kërkohen dy anëtarë të stafit ekzistues të punojnë kryesisht në YourWay (i gjithë stafi aktualisht shesin të gjitha gamat e produkteve në dyqane). Duke marrë parasysh natyrën e veçantë të gamës së produkteve YourWay, drejtori i operacioneve mendon se do të ishte e arsyeshme ofrimi i trajnimit shtesë në shërbimin ndaj klientëve për anëtarët e stafit që punojnë në YourWay.

Duke marrë parasysh trajnimet e dhëna stafit, anëtarët e menaxhmentit vlerësojnë se do të ishte e përshtatshme që të ofrojnë një paketë më të lartë bazike të kompenzit krahasuar me satfin tjetër. Kështu do të paguhet një bonus për stafin e YourWay nëse ata arrijnë një numër treguesish performancash, të cilat do të bazohen në nivelin e pritur të reagimeve të klientëve mbi cilësinë e shërbimit të ofruar për produktet YourWay (asnjë pjesë e bonusit të tyre nuk do të bazohet në shitjet e gamave të tjera të produkteve të ABC Travel).

Rezultatet e projekt pilotit

Bordi i Drejtorëve autorizoi një pilotim të propozimeve të Departamentit të Operacioneve në tre dyqane të mëdha. Pas katër muajve, reagimet e klientëve për dyqanet e reja kanë qenë të favorshme. Megjithatë, janë bërë ankesa se koha e pritjes në dyqan për të folur me një ndihmës (për të gjitha produktet) është rritur.

Reagimet nga punonjësit kanë qenë më të përziera, me një numër ankesash në lidhje me operacionet e reja. Këto përfshijnë:

• Punonjësit që nuk janë pjesë e YourWay (ose stafi "standard", siç i referohet menaxhmenti i ABC Travel) kanë ankesa në lidhje me trajnimin shtesë që marrin anëtarët e stafit YourWay. Ata kanë kërkuar herë pas here trajnime të rregullta për produkte në të kaluarën, por këto kërkesa janë refuzuar me arsyetimin se nuk ishin të efektshme në aspektin e kostos dhe se punonjësit duhet të jenë në gjendje ta bëjnë këtë në kohën e tyre të lirë.

• Ka pasur ankesa gjithashtu për strukturën e re të pagave, me punonjësit e zakonshëm që ndjejnë se nuk vlerësohen siç duhet, ndërsa stafi YourWay ka ankesuar se bonuset e tyre janë më të rrepta dhe më të vështira për t'u arritur krahasuar me punonjësit e zakonshëm.

• Disa punonjës të zakonshëm kanë sugjeruar se kanë dëgjuar stafin YourWay duke dhënë klientëve informacion të pasaktë dhe shërbim të dobët kur shesin produkte të tjera. Përgjigja e menaxhmentit ka qenë të rekomandojë që stafi YourWay të fokusohet në shitjen e produkteve YourWay dhe të shmangë kontaktin me klientët që nuk janë të interesuar për produktet YourWay në masë të mundshme.

Ka pasur raportime për disa probleme në marrëdhëniet e punës në dyqanet pilot, me disa punonjës të zakonshëm që refuzojnë të flasin me anëtarët e stafit YourWay. Kjo ndryshon ndjeshëm me frymën e shkëlqyer ekipore në dyqanet e ABC Travel që nuk janë pjesë e pilotit, ku të gjithë punonjësit bashkëpunojnë për të shitur të gjitha gamat e produkteve dhe vlerësohen si një grup në bazë të shitjeve totale të dyqanit.

Duke marrë parasysh numrin relativisht të vogël të anëtarëve të stafit YourWay në secilin degë, ata raportojnë drejtpërdrejtë te menaxherët rajonalë të ABC Travel, në vend të menaxherëve individualë të dyqaneve.

Kërkohet:

(a) Analizoni kulturën në dyqanet pilot të YourWay dhe shpjegoni pse është e mundshme që ka shkaktuar probleme sjelljeje te anëtarët e stafit. **(15 pikë)**

(b) Vlerësoni KATËR qasje potenciale të udhëheqjes që ABC Travel mund të përdorë për të trajtuar rezistencën e stafit nëse piloti YourWay zgjerohet në dyqanet e tjera të ABC Travel.

(10 pikë)

(Total: 25 pikë)

Zgjidhja e Problemit 2

(a) Analiza e kulturës së dyqaneve të rindërtuara

Sipas Charles Handy, kultura korporative është 'mënyra se si bëjmë gjërat këtu'. Analiza e kulturës shqyrton mënyrën se si stafi ndërveprojnë dhe sjellin ndaj njëri-tjetrit dhe se çfarë besojnë ata për organizatën. Kjo mund t'i japë ABC Travel një tregues përse ka pasur probleme sjelljeje të stafit në dyqanet e rindërtuara. Ka disa modele që mund të përdoren për të analizuar kulturën, por Rrjeti Kulturor mund të jetë më efektiv në këtë rast.

Historitë dhe mitet

Ky aspekt shikon se çfarë historish përcjellin punonjësit njëri-tjetrit brenda organizatës - në të vërtetë, se për çfarë bisedojnë stafi. Kjo mund të japë informacion të çmuar në lidhje me mendësinë e tyre.

Në dyqanet pilot të ABC Trave;, ka disa 'histori' që mund të kontribuojnë në pakënaqësinë e punonjësve. Së pari, ka perceptim midis anëtarëve të stafit standard se punonjësit e YourWay zakonisht ofrojnë shërbim të dobët për klientët e udhëtimeve aventurë ose paketa. Stafi standard mund të shqetësohet se bonuset e tyre mund të pësojnë nga humbja e klientëve për shkak të veprimeve të punonjësve të YourWay dhe kjo do të sjellë tensione midis dy grupeve. (Vlerësojini se punonjësit e YourWay nuk përfitojnë ose vlerësohen për shitjet që nuk janë të YourWay, kështu që nuk ka stimulim për ta treguar performancë të mirë kur shesin këto produkte të tjera.)

Kontrollet

Kjo pjesë e kulturës shqyrton se si punonjësit janë kontrolluar dhe motivuar nga menaxhmenti.

Punonjësit standard tradicionalisht kanë marrë bonuset bazuar në performancën e tyre financiare në të gjitha kategoritë e produkteve. Anëtarët e stafit YourWay po vlerësohen bazuar në cilësinë e shërbimit që ofrojnë për një kategori të vetme të produkteve.

Fakti që punonjësit YourWay kanë një pagë më të lartë totale se stafi standard përcakton një qëndrim "ata dhe ne" dhe ka të ngjarë të shkaktojë konflikte midis dy grupeve.

Fuqia

Ky aspekt shikon menaxhimin dhe ndikimin e tyre në kulturën korporative.

Menaxhmenti i ABC Travel duket se i favorizon punonjësit e YourWay. Jo vetëm që i kanë ofruar atyre një nivel pagash më të lartë, por duket se kryesisht i kanë injoruar ankesat e punonjësve standard në lidhje me performancën e dobët të punonjësve të YourWay kur shesin produkte të tjera.

Mund të argumentohet se zgjidhja e propozuar nga menaxhmenti (që punonjësit e YourWay thjesht të mos ndihmojnë klientët e tjerë) duket se shpërben punonjësit e

YourWay duke ua dhënë më pak punë. Kjo gjithashtu rrit ngarkesën e punës për stafin standard në dyqan.

Simbolet

Ky aspekt shikon simbolet dhe veprimet simbolike brenda organizatës. Ky aspekt gjithashtu tregon arsyet për konfliktin midis dy grupeve të stafit.

Fakti që menaxhmenti i referohet punonjësve ekzistues si 'standard' mund të konsiderohet si një ofendim për shumicën e fuqisë punëtore dhe sugjeron se punonjësit e YourWay janë superiorë.

Është gjithashtu e mundur që trajnimi të jetë një problem. Punonjësit kanë kërkuar trajnime në të kaluarën, vetëm për të dëgjuar se nuk është e levërdishme nga ana financiare. Fakti që punonjësit e YourWay po marrin trajnime shtesë do të shkaktojë ndërlikime midis dy grupeve.

Rutinat dhe ritualët

Ky aspekt shikon sjelljet dhe veprimet standarde të punonjësve brenda organizatës.

Për ABC Travel, kultura e saj aktuale është ajo ku të gjithë anëtarët e stafit punojnë së bashku për përfitim të përbashkët, duke u vlerësuar si një dyqan i vetëm. Duke hequr punonjësit e YourWay nga skema e bonusit, ata po ndahen nga pjesa tjetër e punonjësve nga menaxhmenti, duke u japur atyre një kulturë të ndryshme dhe potencialisht të pakompatueshme me pjesën tjetër të kompanisë.

Struktura

Ky aspekt shikon se si struktura e organizatës ndikon në kulturën korporative.

Struktura e raportimit është ndryshe për punonjësit e YourWay dhe stafin standard. Punonjësit e YourWay raportojnë drejtpërdrejt te menaxherët rajonalë, ndërsa stafi standard raporton tek menaxherët individualë të dyqaneve. Kjo do të thotë që punonjësit e YourWay mund të kenë më shumë ndikim se punonjësit standard, gjë që shkakton rivalitet midis dy grupeve.

Paradigma

Ky aspekt kombinon aspektet e tjera të rrjetës kulturore dhe shikon kulturën korporative të organizatës në përgjithësi.

Menaxhmenti i ABC Travel ka krijuar një sistem dy-nivelësh në dyqanet pilot, ku veprimet e tyre përkrahin ndjenjën se punonjësit e YourWay janë superiorë ndaj pjesës tjetër të forcës punëtore.

Përveç kësaj, punonjësit e YourWay janë të motivuar në mënyrë të ndryshme nga pjesa tjetër e forcës punëtore dhe kanë qëllime të ndryshme, gjë që do të çojë në jokompatibilitet me punonjësit e tjerë.

Përveçse bëhen ndryshime në strukturën e strategjisë YourWay, ABC Travel mund të presë që këto probleme sjelljeje të fillojnë të ndodhin në pjesën tjetër të organizatës nëse pilot projekti zbatohet.

(b) Qasjet e udhëheqjes

Ka disa qasje të udhëheqjes që ABC Travel mund të ndjekë për të trajtuar problemet e shkaktuara nga strategjia YourWay. Qasjet kyçe u shpjeguan nga Kotter dhe Schlesinger.

Pjesëmarrja dhe angazhimi

Kjo qasje sugjeron që punonjësit duhet të angazhohen në procesin e ndryshimit dhe të kenë pjesë në vendimet që merren.

Për ABC Travel, kjo do të thotë që kompania duhet të hapë propozimet për konsultim më të gjerë me punonjësit para se të vazhdojë. Nëse i gjithë stafi merr pjesë në procesin e vendimmarrjes, ata kanë më shumë gjasa të pranojnë ndryshimet që po bëhen, duke përmirësuar motivimin.

Gjithashtu, punonjësit mund të jenë të pakënaqur me strategjinë në tërësi, duke pasur parasysh ndryshimet e konsiderueshme që ajo përfshin në kulturën e kompanisë. Kjo mund t'i bëjë ata të sugjerojnë ndryshime të gjera në strategjinë YourWay të propozuar që mund të bëjnë të pavlefshme atë.

Edukimi dhe komunikimi

Kjo përfshin bindjen se komunikimi i përfitimeve të ndryshimit ndaj punonjësve do të përmirësojë pranimin e tyre dhe do të zbusë rezistencën ndaj ndryshimeve.

ABC Travel duhet të krijojë një program edukimi për të shpjeguar punonjësve përfitimet e strategjisë YourWay dhe si ndryshimi do të sjellë përfitime të përbashkëta për të gjithë. Komunikimi i qartë dhe i hapur mund të zbusë ankthin dhe rezistencën e punonjësve, duke iu dhënë atyre një kuptim më të mirë të qëllimit dhe vlerës së strategjisë.

Humbja e kontrollit

Kjo qasje e sugjeron që punonjësit do të pranojnë më mirë ndryshimin nëse ndihen se kanë ndikim në procesin e ndryshimit dhe kohë të mjaftueshme për të përshtatur.

ABC Travelduhet të sigurojë që punonjësit kanë një ndikim të qëndrueshëm në strategjinë e YourWay dhe të kenë mundësi të japin mendimet e tyre dhe të bëjnë ndryshime të nevojshme për t'u përshtatur me të.

Është gjithashtu e rëndësishme që ABC Travel të ofrojë stafit kohë të mjaftueshme dhe trajnime për të mësuar se si të përshtaten me ndryshimet e strategjisë, duke zvogëluar ndjesinë e humbjes së kontrollit dhe rritur nivelin e pranimit të ndryshimeve.

Udhëheqja nga shembulli

Kjo qasje sugjeron që udhëheqja e nivelit të lartë të tregojë shembullin pozitiv duke pranuar dhe angazhuar veten në ndryshim.

Në rastin e ABC Travel, menaxhmenti duhet të tregojë se është i angazhuar plotësisht në strategjinë YourWay duke marrë pjesë në trajnime, duke ofruar ndihmë dhe mbështetje për punonjësit dhe duke u përkushtuar në rezultatet e tyre.

Udhëheqja nga shembulli do të ndihmojë në krijimin e besimit dhe angazhimit të punonjësve, duke i bërë ata të ndjehen pjesë e ndryshimit dhe të motivuar për të arritur rezultate pozitive.

Shpërblimet dhe përkrahja

Kjo përfshin përdorimin e shpërblimeve dhe përkrahjes për të inkurajuar pranimin e ndryshimeve nga punonjësit.

ABC Travel mund të ofrojë shpërblime dhe përkrahje të veçanta për punonjësit që angazhohen dhe kontribuojnë aktivisht në strategjinë YourWay. Kjo mund të përfshijë bonuset e performancës, rritjen e pagave dhe ofrimin e mundësive për avancim të punonjësve të YourWay.

Përkrahja dhe shpërblimet e drejtpërdrejta do të inkurajojnë punonjësit të angazhohen në ndryshim dhe të shikojnë përfitimet e tij, duke ndihmuar në përmirësimin e pranimit dhe suksesit të strategjisë YourWay.

Negociata dhe marrëveshja

Kjo do të kërkonte nga ABC Travel të bisedojë me stafin për të gjetur një propozim që është i pranueshëm për të gjitha palët. Mund të përfshijë ofrimin e benefiteve të shtuara për stafin standard për të lehtësuar ndjenjën e tyre si punonjës "klasë e dytë" krahasuar me stafin e YourWay.

Kjo mund të përfshijë ofrimin e trajnimeve të shtuara (që është qartësisht një problem në dyqanet pilot) ose ndryshimin e strukturës së bonusit për të siguruar që ata të mos humbin pas ndërtimit të projektit YourWay.

Megjithëse kjo mund të jetë një mënyrë efektive për të zvogëluar rezistencën, mund të jetë e shtrenjtë. Ofrimi i benefiteve të shtuara për stafin standard mund të çojë në fakt që projekti YourWay të mos jetë më i qëndrueshëm financiarisht.

Manipulimi dhe ko-optimizimi

Kjo përfshin shpërndarjen e informacionit në lidhje me propozimin që është selektiv dhe i deformuar. Për shembull, ABC Trave lmund të mendojë të tregojë stafit të saj se situata financiare e kompanisë është e dobët, ose të lëshojë informacion selektiv në lidhje me marrjen e dobët të disa pakove të Udhëtimeve për të treguar se ndryshimi që sugjerohet është i domosdoshëm.

Megjithëse kjo mund të jetë një zgjidhje e shpejtë dhe e lehtë, ajo mund të sjellë probleme të ardhshme me stafin nëse punonjësit ndjejnë se janë manipuluar.

Menaxhimi i ABC Travel duhet të kujtojë se ata shohin shërbimin miqësor dhe cilësinë e mirë të shërbimit ndaj klientëve si një dallim kyç në treg. Nëse shkaktojnë humbje motivimi tek stafi, kjo mund të komprometojë pikën unike të shitjes së kompanisë dhe të dëmtojë reputacionin e saj në treg.

Problemi 3

